

URDHËR
PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 "Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", i ndryshuar, në vijim të përmirësimit të punës, Ministri i Financave

URDHËRON:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike
 - a) Për bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:
 - Për qytetet e kategorisë së I^{-rë} (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 - Për qytetet e kategorisë së II^{-të} (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
 - Për qytetet e kategorisë së III^{-të} (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
 - Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
 - b) Për lojërat aritmetike që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.
 2. Për lojërat e fatit sportive
 - a) Kategoria "Basti", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.
 - b) Kategoria "Konkurs për parashikimet sportive", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
 3. Për llotaritë
 - a) Llotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.
 - b) Llotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për çdo llotari (leje) të organizuar. Ky fond do të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të çdo llotarie (lojë).
 - 4) Lojërat elektronike. Për lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë. Shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit, janë të detyruara të plotësojnë fondin e ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve të lojërave të fatit brenda datës 31.12.2005.
- Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve.
- Urdhri nr.2152, datë 2.4.2002, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.
- Çdo urdhër që i bie ndesh këtij urdhri shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode